

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i - iii
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5 – 41

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët dhe Bordin Drejtues të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k (më tej referuar si "entiteti"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të entitetit më 31 dhjetor 2023 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistë (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuideojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania

29 mars 2024

Mediana Kodra, FCA



Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2023

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVE			
Huadhënie dhe paradhënie (Factoring), neto	6	52,073,287	14,496,008
Huadhënie dhe paradhënie (Kredi dhe linja kredie), neto	7	661,189,874	445,470,074
Investimi në Qira financiare, neto	8	47,678,367	70,125,737
Aktive Afatgjata Jomateriale	9	9,854,351	9,819,356
Aktivet afatgjata materiale	10	6,253,657	4,168,768
Asete me të drejtë përdorimi	11	20,053,978	25,067,473
TVSH e arkëtueshme	12	10,796,150	13,318,799
Parapagime dhe të tjera të arkëtueshme	13	24,087,650	20,344,632
Asete të marra në riposim	14	979,380	1,050,170
Tatim fitim i parapaguar	15	-	23,393
Mjetet monetare në arkë e në bankë	16	14,304,456	25,920,384
Totali i aktiveve		847,271,150	629,804,794
DETYRIMET			
Hua dhe overdrafte	17	456,321,368	235,140,390
Interesa të pagueshme	18	673,587	305,013
Llogari të pagueshme tregtare	19	214,471	5,989,450
Parapagimet e arkëtuara	20	4,322,984	6,093,576
Detyrime tatimore	21	1,949,984	1,193,604
Qira financiare	22	18,845,597	23,293,752
Llogari të pagueshme të tjera	23	209,626	145,044
Tatim fitimi shtyrë	33	181,257	-
Totali i detyrimeve		482,718,875	272,160,829
KAPITALI			
Kapitali themeltar	24	357,171,044	357,171,044
Kapitali nënshkruar i papaguar		-	-
Humbje të mbartura		472,921	(4,566,538)
Fitimi i ushtrimit		6,908,311	5,039,459
Totali i kapitalit		364,552,276	357,643,965
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		847,271,150	629,804,794

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5-41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga interesat	25	82,581,455	53,809,641
Shpenzime për interesa	26	(27,369,591)	(10,584,712)
Të ardhurat neto nga interesat		55,211,864	43,224,929
Të ardhura të tjera	27	2,889,075	11,077,199
Fitim/(Humbje) nga këmbimet valutore	28	798,410	(5,628,861)
Të ardhurat të tjera operative		3,687,485	5,448,338
Zhvlerësimi neto i Qirave financiare, huave dhe paradhënie faktoring	29	108,552	63,116
Shpenzime personeli	30	(28,946,493)	(23,436,450)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	31	(6,462,454)	(3,630,852)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	32	(14,901,166)	(15,526,354)
Total shpenzime		(50,201,561)	(42,530,540)
Fitimi/(humbja) para tatimit		8,697,788	6,142,727
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(1,789,477)	(1,103,268)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	33	(1,608,220)	(1,103,268)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	33	(181,257)	
Fitimi/(humbja) e vitit		6,908,311	5,039,459
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		6,908,311	5,039,459

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5-41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Statement of Changes in Equity
For the year ended December 31, 2023**

	Subscribed capital	Subscribed unpaid capital	Accumulated loss	Profit/(Loss) of the year	Total
Financial position as at January 1st 2022	294,791,395	(260,240)	(11,144,507)	6,577,969	289,964,617
Total comprehensive income for the year:	-	-	-	5,039,459	5,039,459
Transfer to accumulated losses	-	-	6,577,969	(6,577,969)	-
Capital increase	62,379,649	260,240	-	-	62,639,889
Financial position as at December 31st 2022	357,171,044	-	(4,566,538)	5,039,459	357,643,965
Total comprehensive income for the year:	-	-	-	6,908,311	6,908,311
Transfer to accumulated losses	-	-	5,039,459	(5,039,459)	-
Capital increase	-	-	-	-	-
Financial position as at December 31st 2023	357,171,044	-	472,921	6,908,311	364,552,276

The financial statement has to be read in conjunction with notes set out on pages 5 to 41, forming part of these financial statements.

Financial statements of the Company for the year ended on December 31, 2023 are approved by the legal representative of Crimson Finance Fund Albania sh.p.k on 24 March 2024 and signed as follows by:

Florjan Cukaj
Mr. Florjan Cukaj
Preparer of the financial statements

Dorin Rama
Mr. Dorin Rama
Legal Representative



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Notes	For the year ended as at December 31,2023	For the year ended as at December 31,2022
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitimi para tatimit		8,697,788	6,142,727
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>			
Amortizimi	31	6,462,454	3,630,852
Zhvlerësim hua dhe paradhënie		-	(63,116)
Rënie/(rritje) në qira financiare dhe hua dhe në klientëve	6,7,8	(230,849,709)	(150,224,861)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	12,13,15	(1,196,976)	8,946,279
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	19,21,23,33	(6,743,494)	(1,922,068)
Rritje/(rënie) në Aktiv tatimor të shtyrë		181,257	-
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	20	(1,770,592)	3,754,597
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale		(225,219,272)	(129,735,590)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	9,10,11,14,31	(3,498,053)	(11,939,074)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		(3,498,053)	(11,939,074)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Ripagim i Qirasë financiare	22	(4,448,155)	(4,362,178)
(Ripagim) Të hyrat nga huatë afatgjata	17,18	221,549,552	97,581,872
Rritje kapitali		-	62,379,649
Pagesë kapitali papaguar		-	260,240
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		217,101,397	155,859,583
Ndryshimi neto i Mjeteve Monetare dhe ekuivalente me to		(11,615,928)	14,184,919
Mjetet monetare në fillim të periudhës		25,920,384	11,735,465
Mjetet monetare në fund të periudhës	15	14,304,456	25,920,384

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5-41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Crimson Finance Fund Albania sh.p.k është një institucion financiar jo-bankë i themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar më datë 07/01/2015 pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në bazë të ligjit përkatës në fuqi.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 datë 14/04/2008, “Për shoqëritë tregtare”, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18/12/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 8269, datë 23/12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” miratuar me vendim nr. 01, date 17/01/2013 të Keshillit Mbikëqyres, Crimson Finance Fund Albania sh.p.k ka marrë licencen (nr. 34) më datë 02/10/2015 për ushtrimin e aktivitetit të saj si subjekt financiar jobankë. Aktiviteti normal i shoqërisë ka filluar në këtë date. Gjatë vitit 2021, Shoqëria ka shtuar dhe aktivitetin e kredidhënies sipas vendimit nr. 5847, datë 22/12/2020 “Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë nga subjekti financiar jo banke, Crimson Finance Fund Albania”.

NIPT-i i shoqërisë është L51307031A.

Objekti i aktivitetit të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k, i paraqitur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Bankës së Shqipërisë është si vijon: “Të gjitha format e kredidhënies përfshirë kredi, qira financiare, factoring, Këshillim, trajnim dhe asistence teknike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri, Ndërmjetësim.”

Më datë 31/12/2023 numri i punonjësve është 14 punonjës (2022: 13 punonjës).

Shoqëria drejtohet nga Bordi i Drejtorëve, i përbërë nga pesë anëtarë të zgjedhur nga asambleja e aksionerëve dhe ka dy komitete: Komitetin e Menaxhimit të Riskut dhe Komitetin e Auditimit të Brendshëm, të cilat raportojnë te Bordi i Drejtorëve. Komiteti i Menaxhimit të Riskut dhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm janë të përbërë nga katër anëtarë çdoherë (jo-staf), të zgjedhur nga Bordi i Drejtorëve.

Adresa e regjistruar e zyrave qendrore të Crimson Finance Fund Albania sh.p.k, ndodhet në njësinë administrative nr. 9, rruga Çerçiz Topulli, Pallati Sostige, Nr. 14, Kati 0, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, rrumbullakosur në Lekun më të afërt.

2.1 Deklarata e përrputshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

2.2 Paraqitja e pasqyrave financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

2.3 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që Shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të shoqërisë, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimi më i rëndësishëm i gjykimeve dhe vlerësimeve është si vijon:

2.4.1 Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Shoqëria rishikon portofolet e saj të qirave financiare dhe hua dhe paradhënie faktoring në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Shoqëria bën gjykim për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol huaje para se rënia të mund të identifikohet me një hua dhe paradhënie individuale në këtë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësit, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e qirasë financiare ose huamarrjes faktoring nga huamarrësit.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në datën e raportimit të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektive dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet dhe detyrimet jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj, rivlerësohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja neto nga ndryshimi i kurseve të këmbimit paraqitet në zërin "Fitimi/(humbje) neto nga këmbimet valutore" në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse.

Kursi i këmbimit të aplikuar (nga LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore në fund viti më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 ka qenë si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
EUR/LEK	103.88	114.23
USD/LEK	93.94	107.05

3.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

a) Investime në qira financiare, neto

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Interesi efektiv në rastin e instrumentave të Shoqërisë ndryshon nga ai nominal vetëm për komisionin e disbursimit që aplikohet vetëm në momentin fillestar të dhënies së qirave financiare. Të ardhurat e interesit llogariten fillimisht me normën nominale të interesit ndërsa komisioni i disbursimit, që është pjesë e normës efektive të interesit, njihet progresivisht si e ardhur në mënyrë lineare përgjatë afatit të financimit. Në këtë mënyrë, metoda e njohjes së të ardhurave nga interesi nuk ndryshon në mënyrë materiale nga metoda e interesit efektiv.

b) Hua dhe paradhënie faktoring

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Interesi efektiv në rastin e instrumentave të Shoqërisë ndryshon nga ai nominal vetëm për komisionin e disbursimit që aplikohet vetëm në momentin fillestar të dhënies së huasë faktoring. Të ardhurat e interesit llogariten fillimisht me normën nominale të interesit ndërsa komisioni i disbursimit, që është pjesë e normës efektive të interesit, njihet progresivisht si e ardhur në mënyrë lineare përgjatë afatit të financimit. Në këtë mënyrë, metoda e njohjes së të ardhurave nga interesi nuk ndryshon në mënyrë materiale nga metoda e interesit efektiv.

3 Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Pagesat e qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Shoqëria si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë tek Shoqëria në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operationale. Pagesat e qirasë operationale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Qiratë ku Shoqëria transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si investim neto në qira financiare. Fillimi i qirasë është data e disbursimit të fondeve. Në këtë datë:

- një qira klasifikohet si qira financiare dhe;
- përcaktohen shumat që do të njihen me fillimin e afatit të qirasë.

Fillimi i qirasë është data në të cilën qiramarrësi ka të drejtë të përdorë aktivin e blerë me qira financiare. Kjo është data e njohjes fillestare të qirasë (p.sh. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë nga investimi neto në qira financiare, sipas rastit). Në pasqyrën e pozicionit financiar, Shoqëria paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare neto. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara.

Të ardhurat nga investimi neto në qira financiare të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënësi në fillim të afatit të qirasë financiare janë vlera e drejtë e aktivitetit, ose nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e investimit neto në qira financiare, duke përdorur politikën e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. qiratë financiare, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se kredite dhe investimi neto në qira financiare kanë karakteristikë të ngjashme rreziku.

3.4 Hua dhe paradhënie, factoring

Kontratat Faktoring, të cilat rregullohen në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006, "Për Faktoringun", përmbajnë 3 palë: Faktorin, Furnizuesin dhe Debitorin, të përshkruara shprehimisht në këtë ligj.

Shoqëria si një faktor

Hua-të dhe paradhënie faktoring përfaqësohen nga dy nënprodukte financiare të ofruara nga Shoqëria, për të cilat kjo e fundit përfaqëson në të dyja rastet faktorin.

- Faktoring-u i drejtpërdrejtë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të shitjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Furnizuesi luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Gjithashtu, në rast mos-shlyerje të vleres së principalit nga ana e debitorit, furnizuesi mbetet debitor/ garant edhe për shumën e principalit të financuar nga faktori, e cila e ben këtë formë faktoring-u "me garanci".
- Faktoring-u i anasjelltë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të blerjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Debitori luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Në këtë formë faktoring-u, furnizuesi bëhet pjesë e kontratës së faktoring-ut me qëllim transferimin e të drejtave të faturave të financuara, nga furnizuesi tek faktori. Debitori mbetet përgjegjës për rikthimin e vlerës së faturave të financuara në perfundim të afatit të kontratës faktoring.

3 Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4 Hua dhe paradhënie, factoring (vazhdim)

Shoqëria përllogarit dhe bën të pagueshëm një interes fiks nominal mbi balancën mujore të papaguar që përbëhet nga shuma e faturave të financuara. Ripagesa e principalit bëhet e kërkueshme në përfundim të afatit të kontratës factoring.

3.5 Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

a. Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të pazbritshëm.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

b. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivitetet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyrojnë rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

c. TVSH e arkëtueshme

Në bazë të nenit 71 të Ligjit nr. 92 datë 27.04.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, shoqëritë me “aktivitet miks” si taksapagues që kanë aktivitete të cilat janë subjekt të TVSH-së dhe rrjedhimisht kanë TVSH të zbritshme, si dhe aktivitete që janë të përjashtuar nga TVSH-ja. Këta subjekte mund ta zbresin TVSH-në në blerje që u shërbejnë të dyja aktiviteteve, si një përqindje (proporcionalisht) mbi volumin e aktivitetit të tatueshëm. Ndërsa përsa i përket blerjeve që u shërbejnë vetëm aktivitetit të tatueshëm, TVSH-ja e tyre është plotësisht e zbritshme dhe anasjelltas.

3 Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5 Tatimet (vazhdim)

c. TVSH e arkëtueshme (vazhdim)

Metoda e llogaritjes së koeficientit të zbritjes së TVSH-së detajohet në nenin 72 të Ligjit mbi TVSH-në, sipas së cilët theksohet se ky koeficient llogaritet nga raporti i mëposhtëm:

- në numërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet që sjellin të drejtën e zbritjes
- në emërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet e përfshira në numërues dhe me transaksionet që nuk sjellin të drejtën e zbritjes.

Koeficienti i zbritjes së TVSH-së përcaktohet mbi bazë vjetore; koeficienti i zbritjes së TVSH-së e aplikueshme provizorisht për një vit, është koeficienti fillestar i zbritjes dhe ky koeficient llogaritet mbi bazën e transaksioneve të vitit të mëparshëm (ose për llogaritet për vitin e parë të aktivitetit miks). Pas fundit të vitit, taksapaguesi duhet të llogarisë koeficientin e zbritjes së TVSH-së dhe të rregullojë në mënyrë prospektive TVSH-në e arkëtueshme bazuar në këte koeficient. Shoqëria ka llogaritur koeficientit e zbritjes së TVSH-së dhe ka rregulluar TVSH e arkëtueshme nga aktivitete e tjera përveç qirasë financiare.

3.6 Instrumentat financiarë

a. Njohja dhe çrregjistrimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

b. Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivitet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

c. Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i. Aktivitet financiare me kosto të amortizuar

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera. Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, të arkëtueshmet nga qiraja financiare. si dhe obligacioneve të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Instrumentat financiarë njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

c. Matja e mëpasshme e aktiveve financiar (vazhdim)

ii. Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivët financiarë që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të arkëtuar flukset e ardhshme kontraktuale" ose "mbajtja për të arkëtuar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivët financiarë, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investimet në kapital. Aktivët në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

iii. Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Shoqëria llogarit aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çrregjistrimit të aktivit.

d. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhme për të njohur humbjet e pritshme të kreditisë – "modeli i humbjeve të pritshme të kreditisë (ECL)". Kjo zëvendëson "modelin e humbjeve të ndodhura" sipas SNK 39. Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinë kreditë dhe aktivët e tjera financiare të huasë të matura me koston e amortizuar, llogaritë të arkëtueshme, aktivët financiarë të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivët e kontraktuar të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi bazë individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në pritshmërinë për të arkëtuar flukset e ardhshme monetare të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumenteve financiarë që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ("Faza 1") dhe
- instrumenteve financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilëve nuk është i ulët (Faza 2).
- 'Faza 3' do të mbulojë aktivët financiarë që kanë tregues objektivë të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kredisë "12 – mujore" njihen për kategorinë e parë, ndërsa "humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit" njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7 Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të shoqërisë.

3.8 Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre muajor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.9 Aktive afatgjata materiale

a. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes, kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

b. Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse.

c. Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	Jetëgjatësia	Amortizimi (%)
Pajisje elektronike dhe kompjutera	4 vite	25%
Pajisje zyre	5 vite	20%
Mjete transporti	5 vite	20%

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10 Aktivitet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalese.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivitet mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivitet me të drejtë përdorimi dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin me të drejtë përdorimi kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

3.11 Borxhi i varur

Huamarrjet nga ortakët janë burimet kryesore të financimit të shoqërisë. Huamarrjet nga ortakët maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar, përveçse në rastet kur Shoqëria zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.

Shoqëria nuk ka më borxh të varur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 me ortakët e saj.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Organet publike shtetërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

Shoqëria gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në shoqëri nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13 Çështjet e lidhura me klimën

Rreziku i shkaktuar nga ndryshimet klimatike mund të ketë efekte negative në të ardhmen në aktivitetin e Shoqërisë. Këto rreziqe përfshijnë rreziqet e tranzicionit (ndryshimet rregullatore dhe rrezikun e reputacionit) dhe rreziqet fizike (edhe nëse rreziku i dëmtimit fizik është i ulët për shkak të aktiviteteve të Shoqërisë dhe vendndodhjeve gjeografike). Aktiviteti i Shoqërisë mund të ndikohet nga rregullat dhe ndryshimet e reja.

Njësoj si dhe vitin e kaluar, më 31 dhjetor 2023, Shoqëria nuk ka identifikuar rreziqe të rëndësishme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike që mund të ndikojnë negativisht dhe materialisht në pasqyrat financiare të saj. Drejtimi vlerëson vazhdimisht ndikimin e çështjeve të lidhura me klimën në aktivitetin e Shoqërisë.

Gjykimi mund të ndryshojë në të ardhmen në përgjigje të rregulloreve të ardhshme mjedisore dhe rregullatore dhe angazhimeve të reja të marra. Këto ndryshime, nëse nuk parashikohen, mund të kenë ndikim në flukset e ardhshme të parasë së Shoqërisë, performancën financiare dhe pozicionin financiar.

4. Zbatimi i standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar

4.1 Standardet e reja të adoptuara më 1 Janar 2023

Standardet e reja dhe të ndryshuara në vijim nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë dhe për pasojë nuk është dhënë informacion shpjegues në lidhje me këto standarde:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12)
- Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël (Shtesa në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 e SNRF)
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime në SNK 8)
- Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat e Modelit të Dytë (Ndryshime në SNK 12)

4.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e Standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar më herët nga banka

Standardet e reja dhe të ndryshuara në vijim nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë dhe për pasojë nuk është dhënë informacion shpjegues në lidhje me këto standarde:

- Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtër apo Afatgjatë (Ndryshime në SNK 1)
- Detyrimi i Qirasë financiare në Shitje dhe Rimarrje me qira (Ndryshime në SNRF 16)
- Marrëdhëniet e Financimit të Furnizuesit (Ndryshime në SNK 7 dhe SNFR 7)
- Detyrimet Afatgjata me Kushte (Ndryshime në SNK 1)
- Mungesa e Shkëmbyeshmërisë (Ndryshime në SNK 21)

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

(i) Tatimi mbi fitimin

Informata në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit që kanë efekt më të madh në shumën e tatimit mbi fitimin të njohura në pasqyrat financiare, janë përfshirë në shënimet 32. Pozicionet e pasigurta në lidhje me taksat dhe tatimet rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të cdo periudhe raportuese. Detyrimet për tatim fitimin regjistrohen në bazë të vlerësimit nga menaxhmenti që mos të rezultojë në taksa shtesë, nëse normat e tatimit mund të ndryshojnë nga organet tatimore. Vlerësimi është bazuar në interpretimin e ligjeve tatimore që janë në fuqi deri në fund të periudhës së raportimit dhe mbi vendimet gjyqësore apo vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin njihen në bazë të vlerësimit më të mirë nga menaxhmenti të shumës së kërkuar për të shlyer detyrimet.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka cmime tregu të disponueshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përmendura në politikat kontabël 4.6. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të ulët cmimi, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi që varen nga likuiditeti, përqëndrimi, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet mbi cmimin dhe reziqe të tjera që ndikojnë instrumentin specifik. Politikat kontabël të Shoqërisë për matjen e vlerës së drejtë diskutohet në shënimin 4.6.

Shoqëria mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: cmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të gjashëm, cmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk janë të vëzhgueshme dhe të dhënat e pavëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në cmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku rregullimet apo gjykimet e rëndësishme të pavëzhgueshme kerkohen për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Shoqëria përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë cmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit përmbajnë norma interesi e marzhe krediti pa rrezik ose benchmarke, dhe luhatje apo korrelacione cmimesh të pritshme.

